



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 15.09.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës të shoqërisë “Kiss FM” sh.p.k, për subjektin audio privat lokal “Kiss FM ”, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare **(Vendim nr. 103, datë 15.09.2026)**
2. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë “Radio Euro Star Music” sh.p.k, licencuar për subjektin audio privat rajonal “Radio Eurostar” dhe ndryshimin e emrit tregtar nga “Radio Eurostar” në “Radio Popullore”. **(Vendim nr. 104, datë 15.09.2026)**
3. Rrëzimin e propozimit për mosrinovimin e autorizimit të shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “TV 4+”, me zonë ofrimi të shërbimit “Qarku Fier”. **(Vendim nr. 105, datë 15.09.2026)**
4. Mospranimin e propozimit për heqjen e autorizimit të shoqërisë “KL-ED KABËLL” sh.p.k, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor KL-ED”. **(Vendim nr. 106, datë 15.09.2026)**
5. Mospranimin e propozimit për heqjen e licencës së shoqërisë “Fax Media News” sh.a, për subjektin audioviziv “Fax News”. **(Vendim nr. 107, datë 15.09.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 15 shtator 2026